



Datë 08.04.2025

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr. 177/350-13544

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14,15,17,19,20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, Leje Ndërtimore dhe Leje Rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të Ndërtimeve nenit 17, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031 neneve 44,47,48 lidhur me nenin 125, Rregullore mbi tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr.110-79262 datë 22.12.2023, Rregullores për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi Nr.03/2016 datë 04.11.2016 si dhe konform Planit Zhvillimor Komunal 01Nr.016-67691 datë 29.10.2021 dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, DUPM e Suharekë lëshnon këtë:

AKTVENDIM

(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Sabit Selimi	Email :	
Adresa:	Duhël-Suharekë	Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore 07Nr.350-13544 datë: 06.03.2025

Emri i Projektit:	Objekt Afarizem dhe depo
Emri i Projektuesit:	"URBHOMES"
Adresa:	Suharekë

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA I –Objekt i përkohshëm

Adresa: Fshati Duhël, Komuna Suharekë

Zona Kadastrale: Duhël	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
Pronë private e Sylejman, Admir, Mergim Bujari, sipas certifikatës me numër referues 532/2025 datë 03.02.2025, ZK Suharekë, dhe "Kontratë mbi dhënjën në shfrytëzim (Qera) të palujtshmerisë" në afat prej 10 vitesh, e vertetuar te Noteri me numër, LRP.nr.961/2025 datë 22.01.2025	01330-6	Y= 7489533.291	X=4696682.380
		Y= 7489538.062	X=4696688.801
		Y= 7489544.484	X=4696684.030
		Y= 7489552.510	X=4696678.066
		Y= 7489548.336	X=4696672.447
		Y= 7489540.309	X=4696678.411
		Y= 7489539.712	X=4696677.608

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Afarizem dhe depo			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria I			
Gabariti:	134.00 m²	Etazhiteti:	P+0
Vija rregullative:	Nga aksi i profilit të rrugës "Shotë Galica" 31.5m',	Vija ndërtimore:	Nga vija rregullative 8m'

Përshkrimi
Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore të përkohshme Sabit Selimi nga fshati Duhël, Komuna Suharekë, i lejohej ndërtimi i objektit të përkohshëm me konstruksion metalik, afarizëm dhe depo me etazhitet P+0. Leja ka afat kohor për periudhën sa zgjatë marrveshja mes palëve "Kontratë mbi dhënjën në shfrytëzim (Qera) të palujtshmerisë" e vertetuar te Noteri me numër, LRP.nr.961/2025 datë 22.01.2025. Lokacioni i objektit është në kuadër të Hartës Zonale të Komunës 2022-2030, 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ku sipas gjendjes së planifikuar në parcelën kadastrale 01330-6, ZK Duhël – Suharekë, është: Zonë për shfrytëzim të përzier, Kodi: ZSHP-2, sipas Projektit kryesor hartuar nga: " URBHOMES" Suharekë. Objekti ka karakter të përkohshëm me etazhitet P+0. Ndërtimi i objektit të bëhet konform projektit të pranuar nga DUPM e të nënshkruar me numër të Lejes Ndërtimore. Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe në përdhese 134.00 m² Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme: - Informata mbi Lejen Ndërtimore. - Informata mbi Projektuesin. - Informata mbi Kontraktuesin. - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore. - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit. - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent. - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat të realizimit të ndërtimit. - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit. - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur. - Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit.

- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi.
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore.
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Para aplikimit për çertifikim të objektit, poseduesi i Lejes Ndërtimore (Investitori) obligohet të bëjë bashkimin e parcelave.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi Sabit Selimi nga fshati Duhël, Komuna Suharekë, përmes kërkesës 07Nr.350/13544 datë: 06.03.2025, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim Afarizem dhe depo me etazhitet P+0, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimin mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.034/350-66097 datë 28.01.2025
- “Kontratë mbi dhënjën në shfrytëzim (Qera) të palujtshmerisë” në afat prej 10 vitesh, e vertetuar te Noteri me numër, LRP.nr.961/2025 datë 22.01.2025.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.22/25, datës: 03.02.2025 lëshuar nga Kompania Regjionale për Mbeturina “ ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vertetimin e Ujësjiellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor Prizren datë: 03.02.2025.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.039 datë: 07.02.2025.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SHA Nr.132, datë: 21.02.2025.
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terrenit me numër të lëndës 400/2024 të datës 02.03.2025 të punuar nga gjeodeti i licencuar Adriatik Feti me Numër të licencës 2.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike

- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Kopje e dokumentit Identifikues
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit për pagesë 07Nr.133/350-13544 datë 14.03.2025, taksë Administrative 321.60€ sipas faturës komunale me Nr.001419 e paguar në Vllësa-Co, me datë 03.04.2025


Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 01Nr.016-69078 datë 28.10.2022, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtimin e objektivit, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqet ankesë MMPHI-së në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.177/350-13544 datë 08.04.2025

Vendimi i dërgohet: Parashtruesit të kërkesës; Inspektoratit të Komunës; DSHPJK-së; Dosjes së DUPM-së



Drejtori i Drejtorisë:

Visar KUÇI